

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SHARK TECHNOLOGIES” SH.P.K.**

Sot, më date 18.10.2023, une i nenshkruari:

- Denis Karamuça lindur ne Elbasan me 13/01/1998, shtetas Shqiptar, rezident ne Elbasan , mbajtes i leternjoftimit Nr.032994230, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “SHARK TECHNOLOGIES” SH.P.K.. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “SHARK TECHNOLOGIES” SH.P.K

**Neni 2**

- 1.Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Ali Pashe Gucia, pallati Aurora, H.1, ap.2, Tirane
- 2.Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [admin@shark-technologies.com](mailto:admin@shark-technologies.com). Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise

**Neni 3**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Objekti i veprimitarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

- Projektimi, realizimi, menaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informatike dhe te programeve aplikative, si dhe ushtrimin e aktivitetit informatik dhe telematik te kryer ne favor te te treteve, perpunimin e te dhenave per te tretet, realizimin e shitjes se produkteve editorial. Aktivitet te tregtimit, si me pakice ashtu edhe me shumice, me korrespondence dhe me rruge telematike, te produkteve dhe sherbimeve per shoqeri tregtare, per profesioniste dhe persona private, per automatizimin e zyres dhe, ne pernjithesi per informatizimin e te dhenave, si dhe te aparaturave, mobiljeve dhe pajisjeve per zyra. Shoqeria mund te ushtroje detyrat e agjencise dhe perfaqësimit per produkte dhe sherbime objekt i aktivitetit te saj. Shoqeria, me qellim



realizimin e objektit te aktivitetit te saj mund: Te kryeje te gjitha operacionet industriale, tregtare, me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme si dhe financiare ku keto te fundit nuk do te zhvillohen si aktivitet kryesor ndaj publikut. Te zoteroje pjesemarrje (gjithmone jo si aktivitet kryesor dhe jo me publikun) ne shoqeri, ente te çdo natyre si dhe ne konsorciume ekzistuese apo qe do te themelohen dhe te cilat kane objekt aktiviteti te ngashem dhe te cilat jane funksionale per realizimin e objektit te aktivitetit te Shoqerise. Te jape me qellim te realizimit te objektit te aktivitetit dhe jo si aktivitet tregtar primar, garanci ne per gjithesi, dhe ne favor te te treteve. Shoqeria mund tekryeje çdo aktivitet te lejuar nga ligji duke perfshire edhe 2 fusha te veçanta te aktivitetit qe lidhen me marrjen e licencave apo pjesemarrje ne urdhra apo grupime profesionale.

- Megjitheate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është **10.000** (dhjete mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Denis Karamuça: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 10 000 (dhjete mijë) Leke që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

#### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta reperkojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

#### **Neni 7: Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).



- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.  
Pjesët e kapitakit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqerisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarres percaktohen ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 9**

#### **Administrimi**

Aministrator i shoqerise emerohet **Denis Karamuça** lindur ne Elbasan me 13/01/1998, shtetas Shqiptar, rezident ne Elbasan , mbajtes i leternjoftimit Nr.032994230, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje. Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

#### **Neni 10**

#### **Viti finanziar-ekspertët**

Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilit është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 11**

**Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statuin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

**Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

**ORTAKU I SHOQËRISË**

**Denis Karamuça**

Denis Karamuça  
